

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

Pml.nr.39/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit K. J., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.p.nr.645/2023 të datës 21.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.21/2024 të datës 10.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.01.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të pandehurit K. J. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.p.nr.645/2023 të datës 21.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.21/2024 të datës 10.01.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin P.p.nr.645/2023 të datës 21.12.2023, të pandehurit K. J., ia ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323, të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë deri më datë 19.01.2024. Të pandehurit paraburgimi iu është caktuar konform dispozitës së nenit 190, lidhur me nenin 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pikat 1.2.1., 1.2.2. e 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1DP.nr.21/2024 të datës 10.01.2024, e ka refuzuar si e pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit K. J., avokati Avni Ibrahim, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1., nën-paragrafi 2.1., lidhur me nenin 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pikat 1.2.1., 1.2.2. e 1.2.3. të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën, të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit ose të njëjtit t'ia caktoi ndonjë masë më të butë, apo të anulohen aktvendimet e kundërshtuara dhe lëndë t'ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.20/24 e datës 18.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1., lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën e tij pretendon se aktvendimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të pabazuara sepse bazohen në gjendjen e gabuar faktike si dhe në aplikimin e gabuar të dispozitave të procedurës penale, se nuk janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pikat 1.2.1., 1.2.2. e 1.2.3. të KPP-së, ngase nuk ekziston rreziku i ikjes, si dhe i përsëritjes së veprës penale, ngase i mbrojturi i tij është paraqitur vullnetarisht në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në këtë çështje penale janë siguruar të gjitha provat, janë marrë deklaratat e bashkëpandehurve, janë sekuestruar sendet të cilat kanë qenë objekt veprues i veprës penale, andaj nuk ekziston asnjë rrethanë konkrete që tregon se po të ndodhet në liri i njëjti do të pengojë procedurën penale, si dhe është person i pagjykuar, njeri familjar dhe ka qenë vetëm në pozitën e përkthyesit nuk ka pasur asnjë funksion tjetër, përkundrazi edhe vet është i dëmtuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se a do të argumentohen këto fakte është çështje që do të vlerësohet dhe vërtetohet gjatë fazave të më tutjeshme të procedurës. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 184 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se i njëjti ka vendbanim në Republikën e Gjermanisë, andaj me gjetjen e tij në liri i njëjti do të mund të arratiset me qëllim të shmangies

nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.2. të KPP-së, sepse i njëjti mund të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në bashkëpjesëmarrësit, dëshmitarët apo të dëmtuarit me të cilët lehtësisht mund të arrijë në kontakt, andaj caktimi i paraburgimit është i domosdoshëm me qëllim të zhvillimit normal të procedurës penale.

Gjithashtu kjo gjykatë, vlerëson se drejtë është konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 190, paragrafi 1., lidhur me nenin 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.3. të KPP-së, për të pandehurin, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ku i pandehuri me dashje dhe në bashkëveprim me të pandehurin tjetër, fillimisht i kanë bindur të dëmtuarit se do të punësohen në Irak, por pasi që të arrijnë atje, të njëjtit përveç që nuk kishin vende të punës kishin qëndruar në kushte shumë rënda ekonomike, higjienike dhe kishin përjetuar frikë të madhe psiqike, andaj ekziston rreziku se po të gjendet i pandehuri në liri i njëjti do të mund ta përsërisë veprën penale të natyrës së njëjtë apo ndonjë vepër tjetër penale, prandaj caktimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhjen normale të procedurës penale.

Nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 171 të KPP-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.39/2024, më datë 19.01.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi